  3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 850 m<sup>2</sup>, tokë arë, vlerësuar me çmimin 600 lekë/m<sup>2</sup>, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 510 000 (pesëqind e dhjetë mijë) lekë.
  4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 151 000 (njëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
  5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 510 000 (pesëqind e dhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
  6. Shpronësimi të fillojë më 30.11.2007 dhe të përfundojë më 30.12.2007.
  7. Pronari i përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
  8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Nr	Emri	Nr.pasurisë	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Shënime
1.	Shefki Mehmet Dosku	596	850	600	51 0000	Plotësim dokumentacioni
<b>Totali</b>					<b>510000</b>	

# GJENDJA EKZISTUESE


PLANIMETRIA, PROFILA GJATESORE E TERTHORE



# PLANIMETRIA

QIENDJA EKZISTUESE

SH.1:500



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRI DE TRANSPORTI  
DIREKTORATI


OBARTI: ELIMINIMI I RRESHTIT  
'GURI I REXHIT' LIDHUR NE BASHKI  
TE PRROJ I LAURIT  
PLANIMETRIA



# PLANIMETRIA

MASAT ENJINIERERE

SH. 1:500



Verteksa V krijohet nga ndërrperje e dy drejtimeve:  
 -Njeri drejtim do te krijohet nga heshkimi i Pk. 1  
 duke bere e spostuar majtas 5 m! ne Pk. 5 dhe  
 -Drejtimi tjetër krijohet ne drejtim te Pk. 9.  
 te ure HD=3.8m Pk.13, ne drejtim te Pk.9.



OBJEKTI:	ELIMINIMI I RESHQEVE "CURI I RENXIT LIBRASH" PROJEKT-ZBATIM	SH. 1:500
PROJEKTUES	PLANIMETRIA	
ING. GJEOLGJ	Ing. ULLI DIBANE	
SH. 1:500		

V  
 $\alpha = 41^\circ$   
 $R = 75.00$   
 $T = 28.04$

**VENDIM**  
**Nr.849, datë 21.11.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.88, DATË 15.2.2006 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTURORE  
DHE SHPËRBLIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË SPORTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.88, datë 15.2.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 numri “14” bëhet “8” dhe hiqen emërtimet e mëposhtme:

- “- Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit;
- Presidenti i Federatës Shqiptare të Basketbollit;
- Presidenti i Federatës Shqiptare të Volejbollit;
- Presidenti i Federatës Shqiptare të Atletikës;
- Presidenti i Federatës Shqiptare të Peshëngritjes;
- Presidenti i Federatës Shqiptare të Boksit.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Sportit përfitojnë, për pjesëmarrje në çdo mbledhje, një shpërblim prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

Pagesat për shpërblimet të përballohen nga të ardhurat dytësore, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit).”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr.25, datë 30.11.2007**

**PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E  
INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË  
DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË  
KËMBIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 me propozimin e Komisionit *ad-hoc*, Ministri i Financave

## UDHËZON:

### Sesioni I: Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore

1. Me qëllim standardizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, në zbatim të neneve 34-39 të Kodit Doganor procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore fillojnë me pranimin ose jo të vlerës së transaksionit të deklaruar, sipas indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi.

2. Indikatorët mbi të cilat do të mbështetet kjo analizë janë:

2.1 vlerat e mallrave identike apo të ngjashme të pranuar me transaksionin në sistemin doganor brenda 3 muajve të fundit;

2.2 vlera të konfirmuara nga verifikimi i faturave që kanë rezultuar me diferenca;

2.3 vlera e mallrave të dërguara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si të dhëna të disponueshme etj.;

2.4 vlera e produktit nuk mund të jetë më e ulët se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar;

2.5 vendi i origjinës me risk: Azisë, Lindjes së Largët, vendeve arabe, zonave të lira (zona *off-shore*), Amerika Latine;

2.6 në vendin e deklaruar si origjinë malli i deklaruar nuk prodhohet;

2.7 vulat te certifikatat e origjinës janë të dyshimta;

2.8 fatura nuk është lëshuar nga prodhuesi;

2.9 vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet malli;

2.10 marrësi i mallit ka historik shkeljesh;

2.11 vendi i ngarkimit nuk korrespondon me vendin e adresën e eksportuesit;

2.12 mallrat janë të grupuara;

2.13 përshkrimi i mallrave në faturë nuk është i plotë ose me gabime;

2.14 në faturë nuk jepet informacion i plotë, mungojnë të dhënat tel/faks, e-mail, adresë dhe numri i regjistrimit fiskal;

2.15 eksporti i mallit bëhet nga kompani transportuese;

2.16 dërguesi dhe marrësi i mallit janë të lidhur duke krijuar lehtësi për ulje vlere, me kushte përfitimi në fushën e marketingut, investimeve, hyrjes në treg etj.;

2.17 itinierari i transportit të përdorur është i gjatë dhe i pamotivuar ose arsyetuar;

2.18 metoda e pagesës është me para në dorë ose parapagim;

2.19 dokumente jo të printuara por të shkruajtura me dorë;

2.20 diferenca në kohë midis datës së lëshimit të CMR/TIR dhe datës së fillimit të udhëtimit;

2.21 kosto e transportit jo e pajtueshme me çmimet e mallrave të deklaruar;

2.22 kontratë me firmën shitëse;

2.23 deklaratë eksporti nga vendi eksportues;

2.24 fatura të sigurimit të mallit;

2.25 dokumentacione të tjera shpesh që lidhen me sasinë, vlerën, origjinën, transportin, magazinimin, transitimin, mënyrën e pagesës, dokumente justifikuese të kushteve të livrimit të mallit. Për shembull në rastet e deklarimit të kushtit CIF, mund të kërkohen faturat e pagesave për transport dhe siguracion malli.

3. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm justifikohet plotësisht vlera e deklaruar pranohet vlera e transaksionit. Në rastet, kur vlera e deklaruar krahasuar me të “dhënat e disponueshme” të përmendura më sipër është dukshëm më e ulët praktika e plotë i dërgohet për verifikim Departamentit Operativ Hetimor-Drejtorisë së Inteligjencies dhe një kopje njësisë së kontrolleve aposteriori, që janë përgjegjës për verifikimin e plotë brenda dhe jashtë vendit.

Në rastet që rezultojnë të rregullta, pas verifikimit nga Drejtoritë përkatëse dhe përgjegjëse

për shqyrtimin e praktikës, i kthehet përgjigje degës doganore përkatëse, ku është kryer deklarimi. Shkresa në emër të Drejtorit të Përgjithshëm përpilohet nga drejtoria që ka kryer konfirmimin, gjithashtu informohet dhe Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm Teknik.

Në rastet kur ka diferenca në sasi, vlerë, cilësi, origjinë etj., zbatohet neni 261 i Kodit Doganor që parashikon penalizim për kundërvajtjet administrative. Gjithashtu për këto raste informohet Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm Teknik.

4. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues.

Në zbatim të nenit 345 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuar. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërthuara për këtë qëllim në nivel qendror.

5. Vetëm në rastet, kur nuk është e mundur që çmimi i mallit të përcaktohet sipas procedurave të përcaktuara më sipër bazuar në nenet 34, 35 të Kodit Doganor, si bazë vlerësimi mund të përdoret “dosja e të dhënave të disponueshme”.

5.1 Në rastet, kur njësia matëse e mallit të deklaruar nuk i korrespondon njësisë matëse të mallit të përshkruar në dosjen e të dhënave të disponueshme, të bëhet konvertimi i njësisë matëse duke aplikuar njësinë matëse të përshkruar në dosje.

5.2 Në rastet, kur për mallin e deklaruar nuk është e mundur të gjendet në “dosjen e të dhënave të disponueshme” atëherë në degën doganore ngrihet grup pune për përcaktimin e vlerës së mallit dhe vihet në dijeni zyrtarisht me shkrim Zëvendës Drejtori i Departamentit Teknik.

5/3 Në rastet e deklarimit të mallrave me pjesë, vlera e pjesëve duhet llogaritur sipas peshës që zë në vlerën e mallit të përfunduar.

5.4 Në rastet e importit të mallrave të përdorura nga dega doganore të ngrihet komision për vlerësimin e tyre që duhet të përcaktojë shkallën e amortizimit të mallrave për të cilat bazë llogaritjesh duhet të jenë vlera referuese, viti i prodhimit dhe vlera e llogaritur nuk mund të jetë më e vogël se 30% e vlerës së mallit të ri.

6. Përcaktimi i vlerës së mallit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar me shenjë “X”. Shqyrtimi i mostrave të mallit, duhet të jetë pjesë e detyrueshme e procedurave të vlerësimit të mallit.

7. Monitorimi dhe mbikëqyrja e procedurave të parashikuara në këtë udhëzim është detyrë e Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm, Njësisë së kontrolleve aposteriori, sektorit të vlerës, drejtorisë së informacionit.

8. Strukturat e parashikuara në pikën 7 dërgojnë me miratim të eprorëve të drejtpërdrejtë për dijeni informacion me shkrim të Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm Teknik për shkeljet e konstatuara, si dhe vënë në dijeni eprorët e punonjësve që iu janë konstatuar shkelje.

9. Bashkëngjitur do të gjeni dy ankese 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, që janë pjesë përbërëse e tij:

Aneks 1: Indikatorët e shqyrtimit të vlerës doganore

Aneks 2: Inkotermat e azhurnuar

Sesioni II: Burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme

10. Si burim informacioni për krijimin e dosjes me “Të dhënat e disponueshme” shërbejnë burimet e përcaktuara në pikat 10.1 deri në pikën 10.7, si më poshtë vijon:

10.1 Çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të marra nga Agjencia “Reuters”;

10.2 Buletine të tjera zyrtare ndërkombëtare, që mund të përdoren për vlerësimin doganor të çmimeve të çeliqueve, si “Steel Week” Metal Bulletin”;

10.3 Fatura të konfirmuara nga Departamenti Operativo-Hetimor (DOH), marrëveshjet me homologët doganorë;

10.4 Çmime të publikuara në Eurostat dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT);

10.5 Buletine të çmimeve të automjeteve si: “Quattroroute”, “Tuttotransproti”, “Zacke”

dhe TecDoc;

10.6 Të dhëna statistikore të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

10.7 Statistikat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për tregtinë.

10.8 Oferta dhe publikimi nga interneti etj.

11. Afatet e azhurnimit dhe publikimit të çmimeve janë përcaktuar si më poshtë, në pikat 11.1,11.2,11.3 dhe 11.4.

11.1 Për artikujt e karburanteve të tilla si benzinë, gazoil, mazut, vajgurë, gazi i lëngshëm (butan,propan), sektori i vlerës harton shkresën dhe, pas firmosjes nga titullarët e institucionit e dërgon me faks në qendrën e ndërlidhjes së DPD-së dhe kjo e fundit e dërgon me faks në degët doganore, afati i publikimit është çdo ditë.

11.2 Për artikujt grurë dhe misër, sektori i vlerës harton shkresën dhe, pas firmosjes nga titullarët e institucionit e dërgon me faks në qendrën e ndërlidhjes së DPD-së dhe kjo e fundit e dërgon me faks në degët doganore, afati i publikimit është çdo muaj. Nëse brenda kësaj periudhe ndryshimet janë  $\pm 10\%$  e çmimit të publikuar, atëherë bëhet publikimi i ri i tij, si më sipër.

11.3 Për artikujt oriz, sheqer, vaj ushqimor, miell dhe produktet e çelikut si hekur ndërtimi, llamarinë e zezë, profile çeliku, tel, prokate, skrape, llamarinë inoksi etj., afati i publikimit është çdo muaj. Nëse brenda kësaj periudhe ndryshimet janë  $\pm 10\%$  e çmimit të publikuar, atëherë bëhet publikimi i ri i tij.

11.4 Artikujt të tjerë të papërfshirë në pikat 11.1, 11.2 dhe 11.3 përditësohen duke u bazuar në burimet e përmendura në pikën 10 sa herë që ka luhatje çmimesh. Nëse brenda kësaj periudhe ndryshimet janë  $\pm 10\%$  e çmimit të publikuar, atëherë bëhet publikimi i ri i tij.

11.5 Për artikujt që nuk është siguruar informacion nga burimet e përmendura në pikën 10, vendosja apo rishikimi i çmimeve të tyre në dosjen me të dhëna të disponueshme”, të bëhet nga sektori i vlerës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Seksioni III. Zhdoganimi i automjeteve

12. Për vlerësimin e automjeteve të përdorura si burim informacioni të shërbejnë buletinet: “QUATTRORROUTE”, “TUTTOTRASPORTI”, “ZACKE” etj., që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet europiane.

13. Vlera e një autoveture do të gjendet në tabelë (“QUATTRORROUTE”) duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast vlera doganore nuk duhet të jetë më e ulët se 70% e çmimit të gjendur në tabelë.

14. Vlera e një kamionçine nga furgoni ose kamioni do të gjendet në tabelën (“TUTTOTRASPORTI”) duke u nisur: marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast vlera doganore nuk duhet të jetë më e ulët se 90% e çmimit të gjendur në tabelë.

15. Kur për autoveturën që vlerësohet në buletin nuk gjendet modeli, vlerësimi të bëhet duke u nisur nga modeli dhe cilindrata më e afërt. Në këtë rast vlera nuk duhet të jetë më e ulët se 70% e çmimit që jepet në tabelë.

16. Për llogaritjen e vlerës doganore të automjeteve të nxjerra nga buletinet, në asnjë rast çmimet nuk mund të merren më të ulëta se ato sipas pikës 17.

17. Në vlerësimin e automjeteve me vit prodhimi, para vitit të fundit të publikuar në buletin, vlera nuk mund të llogaritet më pak se:

17.1 Për autoveturat:

a) Deri 1400 cc jo më pak se 100 000 lekë

b) Mbi 1400-1900 cc jo më pak se 150 000 lekë

c) Mbi 1900-2500 cc jo më pak se 250 000 lekë

d) Mbi 2500-3000 cc jo më pak se 300 000 lekë

e) Mbi 3000 cc jo më pak se 350 000 lekë

17.2 Kamionçinë, furgonë dhe kamionë:

a) Deri në 3.5 tonë jo më pak se 480 000 lekë

b) Mbi 3.5-10 tonë jo më pak se 600 000 lekë

c) Mbi 10 tonë jo më pak se 840 000 lekë

18. Për mjetet e transportit të udhëtarëve (autobusë dhe furgonë) vlera doganore sipas viteve të prodhimit të llogaritet jo më e vogël se vlerat e përcaktuara në listën bashkëngjitur këtij udhëzimi.

19. Azhurnimi i të dhënave që sigurohen nga buletinet e çmimeve të bëhet dy herë në vit sipas njoftimit zyrtar nga DPD-ja.

Sesioni IV. Zhdoganimi i pjesëve të këmbimit për automjete

20. Fatura e paraqitur për zhdoganim duhet të pasqyrojë numrin identifikues të artikullit. Kur fatura nuk e përmban këtë element, duhet t'i kërkohet subjektit depozitimi i një dokumenti, ku të identifikohet çdo artikull me kodin identifikues të tij.

21. Bazuar në nenin 12, pika 2 të Kodit Doganor zhdoganimi i pjesëve të këmbimit do të kryhet për të gjitha subjektet detyrimisht pranë Degës Doganore, Tiranë.

22. Burimi i informacionit janë të dhënat e përcaktuara në pikën 10 të këtij udhëzimi.

23. Për çdo artikull që zhdogonohet duhet të futet kodi në programin e instaluar për këtë qëllim dhe të aplikohet një ulje deri në 80%.

24. Vlera që rezulton pas zbritjes të shërbejë për doganierët e vlerësimit si një indikator i rëndësishëm vlerësimi në shqyrtimin e vlerave të transaksionit të deklaruar.

25. Kur çmimi i faturës është poshtë kësaj vlere, atëherë ky fakt mund të shërbejë për rivlerësimin e mallit të deklaruar.

26. Kur mallrat nuk janë të identifikueshme, sipas metodës së mësipërme, për vlerësim përdoret një nga metodat alternative të vlerësimit të parashikuar në Kodin Doganor.

27. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**

Shtojca 1: Procesverbali i kontrollit të vlerës doganore

Nr	Indikatore
1	Vlerat e mallrave identike të pranuar me transaksion në sistemin doganor brenda 3 muajve të fundit
2	Vlera të verifikuara nga verifikimi i faturave që kanë rezultuar me diferenca
3	Vlerat e mallrave të derguara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si të dhëna të disponueshme tregtare, vlera referuese
4	Vlera e nënproduktit nuk mund të jetë më e lartë se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar
5	Vendi i origjinës me risk: Azisë, Lindjes së Lartë, Zonave të Lira
6	Në vendin e deklaruar si origjinë malli i deklaruar nuk prodhohet
7	Vulat tek certifikat e origjinës janë të dyshimta
8	Fatura nuk është leshuar nga prodhuesi
9	Vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet malli
10	Marresi i mallit ka historik shkeljesh
11	Mallrat janë të grupuara
12	Përshkrimi i mallrave në fature nuk është i plotë dhe me gabime
13	Në fature nuk jepet informacion i plotë, mungojnë të dhënat tel/faks, email, adresë, dhe numri i regjistrimit fiskal
14	Eksporti i mallit bëhet nga kompani transportuese
15	Derguesi dhe Marresi i mallit janë të lidhur duke krijuar lehtësi për skonto me kushte përfitimi në fushën e marketingut, investimeve, hyrjes në treg etj.
16	Itinerari i transportit të përdorur është i gjatë pa motiv
17	Metoda e pagesës është me para në dorë ose parapagim
18	Dokumenta jo të printuara por të shkruajtura me dorë
19	Diferenca në kohë midis datës së leshimit të CMR/TIR dhe datës së fillimit të udhëtimit
20	Kosto e transportit jo kompatible me çmimet e mallrave të deklaruar
21	Kontrata me Firmën shitëse
22	Deklarate eksporti nga vendi eksportues
23	Fatura të sigurimit të mallit
24	Dokumentacione të tjera shtesë që lidhen me sasine, vlerën origjinën, transportin, magazinimin, tranzitimin, mënyrën e pagesës

Shtojca 2: Inkotermat

Inkotermat	Sigla	Ambalazh	Ngarkuar (ne kamion, vagon, kontenier) ose ne fabrike magazinen e nisjes	Dreguar drejt nje porti, aerporti, platforme grupazhi, terminali nisje	Kalim neper nje port, aerport, platforme grupazhi, terminal nisje	Transporti kryesor	Sigurim transp.	Kalim neper nje port, aerport, platforme grupazhi, terminali mbritje	Formalitet doganore ne import	Dergim tek fabrika ose magazi ne mbritjes	Shkari mar ne fabrike ose ne magazi ne mbritjes	Detar
Levruar ne fabrike	<b>EX W</b>	X	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>P</b>
Levruar buze anijes	<b>FAS</b>	X	X	X	X	-	-	-	-	-	-	<b>D</b>
Levruar tek transportuesi	<b>FCA</b>	X	X	X	X	-	-	-	-	-	-	<b>P</b>
Levruar ne bord	<b>FOB (FAB)</b>	X	X	X	X	-	-	-	-	-	-	<b>D</b>
Cmimi dhe transporti	<b>CFR</b>	X	X	X	X	X	-	-	-	-	-	<b>D</b>
Trasport paguar deri	<b>CPT</b>	X	X	X	X	X	-	-	-	-	-	<b>P</b>
Cmimi, sigurimi, transporti	<b>CIF CAF</b>	X	X	X	X	X	X	-	-	-	-	<b>D</b>
Transport dhe	<b>CIP</b>	X	X	X	X	X	X	-	-	-	-	<b>P</b>





**Shtojca 3: Vlera doganore sipas viteve te prodhimit për mjetet e transportit te udhëtarëve (autobuze dhe fugone)**

*Në mijë lek*

<b>VITI PRODHIMIT</b>	<b>40-49 vende</b>	<b>10-20 vende</b>
<i>Para vitit 1988</i>	<i>Jo me pak se 800</i>	<i>Jo me pak se 600</i>
Viti 1988	1000	650
1989	1200	700
1990	1400	850
1991	1600	1000
1992	1800	1200
1993	2100	1350
1994	2600	1450
1995	3000	1550
1996	3500	1650
1997	4300	1800

1998	5000	2000
1999	6000	2200
2000	8000	2400
2001	9500	2600
2002	11000	2800
2003	13000	3000
2004	15000	3300
2005	17000	3800

**VENDIM**  
**Nr.65, datë 10.12.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR KONSUMATORËT FUNDORË**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "b", 9, 26, pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr.28, datë 24.6.2005, nr.29, datë 24.6.2005, nr.30, datë 24.6.2005, përkatësisht "Metodologjitë e llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, të llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të llogaritjes së tarifave të shitjes te klientët tariforë", si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 38, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike "ERE", në mbledhjen e tij të datës 10.12.2007

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi deri në datën 29 shkurt 2008 të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për konsumatorët fundorë, në përputhje me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.84, datë 14.12.2006 (Tabela bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE  
TË APROVUARA NGA ERE**

Kategoritë e konsumatorëve	Çmimi (lekë/kwh)
Konsumatorë të furnizuar në TL (400/220/110 kV) me asete të zotëruara nga vetë konsumatori	4.50
Konsumatorë të furnizuar në TM (35, 20, 10, 6 kV)	
Buxhetore	9.40
Ujësjetëse buxhetorë	7.00
Ujësjetëse jobuxhetorë	7.00
Ujësjetëse privatë	7.00
Industri private	7.00
Industri jobuxhetore	7.00
Jobuxhetorë të tjerë matur në TM	7.00
Jobuxhetorë të tjerë matur në TU	7.00
Privatë të tjerë matur në TM	7.00
Privatë të tjerë matur në TU	7.00
Prodhues mielli dhe buke	7.00
Stacione pompimi	7.00
Institucione fetare	7.00
Media	7.00
Konsumatorë të furnizuar në TU (0.4 kV)	
Buxhetorë	10.0
Ujësjetëse buxhetorë	7.50
Ujësjetëse jobuxhetorë	7.50
Ujësjetëse privatë	7.50

Industri jobuxhetore	8.00
Jobuxhetorë të tjerë	8.00
Privatë	8.00
Prodhues mielli dhe buke	7.50
Stacione pompimi	7.50
Institucione fetare	8.00
Media	8.00
Konsumatorë familjarë	7.00

Shënim: Energjia e përdorur për ambientet e përbashkëta (ndriçim shkalle, pompë, ashensorë etj.) do të faturohet me 7 lekë/kWh.

**VENDIM**  
**Nr.66, datë 10.12.2007**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ACR ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 të “Rregullores për procedurat e licencimit” nenit 10, pika 1, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “ACR Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ACR Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.67, datë 10.12.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “KALIVAC GREEN ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (HEC I KALIVACIT), SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGIJE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 të “Rregullores për procedurat e licencimit” nenit 10, pika 1, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i

Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**

**Nr.68, datë 10.12.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “b”, nenit 9, nenit 26, pika 1 dhe nenit 41 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.59, datë 29.12.2004 “Metodologjia e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 38, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike “ERE”, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2007

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi deri në datën 29 shkurt 2008 të tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, në përputhje me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.33, datë 26.5.2006.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.**

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

### BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

### *Së shpejti në treg:*

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 14.12.2007  
Doli nga shtypi më 17.12.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 32 lekë